

PROCESVERBAL
nga seanca e 41-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
e mbajtur më 3.11.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të AVMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të AVMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nuk ishte i pranishëm në seancë, për shkak të një udhëtimi zyrtar.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti, mr.Dragica Ljubevska në seancë e zëvendësoi drejtorin e Agjencisë sipas autorizimit nr.03-3556/1 datë 28.9.2022.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr.Arben Saiti, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z.Petrushevski hapi seancën e 41-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca 8-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 20.10.2022.
2. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 20.10.2022.
3. Shqyrtimi i raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 korrik deri më 30 shtator 2022.
4. Propozim-vendim për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet RRPKE që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel lokal.
5. Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit SKUPI KABLE nga Shkupi për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV.
6. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësis ndaj SHTR LA KOSTA nga Vinica.

7. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj TV Alsat-M për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
8. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj TV Alfa për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
9. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj TV Sitel për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
10. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj TV 21-M për shkelje të nenit 55 paragrafët (6) dhe (7) nga LSHMAAV.
11. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj TV Alsat-M për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV.
12. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj TV Alsat-M për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) nga LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi.
13. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e LFP (ligjit për furnizim publik) LPP.
14. Propozim-vendim për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 2 (dy) qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregullores të „Gazetës Zyrtare në Republikën e Maqedonisësë Veriut“.
15. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 8-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 20.10.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 40-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 20.10.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z.Petrushevski paralajmëroi shqyrtimin e Raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 korrik deri më 30 shtator 2022. Ai shpjegoi se Këshilli nuk i voton, por ka mundësi të deklarohen lidhur me përmbajtjen e tyre, e cila përfshin një pasqyrë të detajuar të të gjitha aktiviteteve të ndërmarra të Agjencisë në tre muajt e kaluar.

Z.Ajdini tha se nuk kishte asnjë vërejtje lidhur me raportet e dorëzuara tremujore. Nga ajo që kishte lexuar, shihet qartë se Agjencia ka punuar në maksimum, tregohen të gjitha aktivitetet në detaje, duke filluar nga mbikëqyrjet, masat e ndërmarra ndaj transmetuesve si vërejtjet publike, procedurat për kundërvajtje, më pas bashkëpunimi ndërkombëtar dhe një sërë aktivitete të tjera që janë në kuadër të punës së Agjencisë. Ai deklaroi se i pranon raportet.

Z.Petrushevski tha se pasi i ka lexuar raportet tremujore ka konstatuar se puna e Agjencisë është vërtetë gjithëpërfshirëse dhe ka shumë të punësuar që kanë dhënë kontributin e tyre. Ai theksoi se niveli i punës së Agjencisë është me të vërtetë i lartë dhe duhet edhe më tej të vazhdohet me këtë cilësi të punës.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për përkrajen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef kabineti mr.Dragica Ljubevska shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e lejes për transmetim televiziv përmes RRPKE që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel lokal. Ajo shpjegoi se leja do t'i jepet personit fizik Amir Hamiti nga Kumanova, i cili më 12 korrik të këtij viti ka paraqitur kërkesë në Agjenci për dhënien e lejes së specifikuar.Shërbimi profesional e ka shqyrtuar kërkesën dhe ka konstatuar se ajo nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt, dhe për këtë është njoftuar dhe vetë parashtuesi i kërkesës. Më 30 gusht, Amir Hamiti sërish ka paraqitur një plotësim(amandament) në kërkesë, por edhe këtë herë ka pasur mangësi, pas së cilës është njoftuar sërish. Më pas, më 4 tetor, për herë të tretë, personi fizik në fjalë ka paraqitur kërkesë për dhënien e lejes dhe është konstatuar se kërkesa kësaj radhe është dorëzuar në rregull. Duke pasur parasysh këtë, i propozohet Këshillit që të japë lejen e kërkuar dhe pas dhënies poseduesi duhet të themelojë Shoqërin Tregtare Radiodifuzive, e cila obligohet të fillojë menjëherë veprimtarinë më 1.12.2022.

Z.Petrushevski tha se Kërkesa për dhënien e lejes për të është vërtetë befasi në këtë periudhë të rëndë të krizës ekonomike dhe energjitike, për të pasur dëshirë për të investuar në hapjen e një mediumi të ri. Ai shpreson se z. Amir Hamiti do të ketë mundësi (fuqi) për ta realizuar këtë sepse ka ende shumë punë për të bërë. Kohët e fundit është një rast i rrallë kur mediat për shkak të krizës lënë punën, për të hapur një media të re.

Z.Ajdini tha se, siç sqaroi dhe udhëheqësja Ljubevska, personi disa herë ka paraqitur Kërkesë dhe ka tentuar të dorëzojë dokumentacionin në pajtueshmëri me Ligjin, por në fund me ndihmën e shërbimeve e ka përfunduar me sukses të gjithë procedurën. Siç tha dhe z.Petrushevski, kohë të gjatë nuk kanë pasur rast të tillë, të dhënies së lejes, që paraqet një hap inkurajus dhe shpreson se vendimin për dhënien e lejes do ta arsyetojnë me punë profesionale.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendimi për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën shqipe, në nivel lokal në Komunën e Kumanovës, Komunën e Likovës dhe Komunën e (staro)Nagoriçit, personit fizik Amir Hamiti nga Kumanova, me tekst siç ishte propozuar në vendim.

Shërbimi programor televiziv do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor burim (resurs) të kufizuar.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi fizik Amir Hamiti nga Kumanova, të cilit i dhënë leja, obligohet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së tij më 1.12.2022.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Z.Petrushevski pas votimit e përgëzoi poseduesin në emër të Këshillit për vendimin dhe i uroi që edhe përkundër kohëve të vështira, të ketë sukses në ringjalljen e medias dhe të fillojë punën në afatin e caktuar.

Pika 5

Udhëheqësja Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit SKUPI KABLE nga Shkupi për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se më 17 tetor mbi operatorin e përmendur është kryer mbikëqyrje e rregullt, sipas së cilës u konstatua se për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor „SHOW TV“, i cili nuk mbulohet me çertifikatën për regjistrimin e shërbimeve programore të dhëna nga Agjencia. Në maj të 2022 SKUPI KABLE ka marrë Vendim për vërejtje publike për arsye të ritransmetimit të shërbimeve programore të paregjistruara, dhe meqënëse bëhet fjalë për përsëritjen e shkeljes nga po i njëjti nen i ligjit, propozohet ngritja e procedurës për kundërvajtje.

Z.Petrushevski sqaroi se në pajtim me Ligjin, Këshilli nuk ka zgjidhje tjetër përveç shqiptim të masës.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes së rregullt programore me nr.11-3845/1 datë 18.10.2022 ndaj Shoqërisë për Telekomunikacion SKUPI KABLE SHPK Shkup, konstatoi shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë njëzëri konkludoi se kundër Shoqërisë për Telekomunikacion SKUPI KABLE SHPK Shkup të iniciojë procedurë për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se operatori në fjalë i cili sipas njoftimit (notifikimit) të Agjencisë për komunikime elektronike mund të kryejë veprimtarinë në komunën Araçinë dhe Shkup, më 17.10.2022 për shfrytëzuesit ka ritransmetuar shërbimin programor „SHOW TV“, i cili nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore e dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për operatorin në fjalë.

Pika 6

Udhëheqësja Ljubevska ka shpjeguar Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësis ndaj SHTR RADIO LA KOSTA nga Vinica. Ajo shpjegoi se më 14 tetor 2022 është dorëzuar njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësis nga transmetuesi në fjalë. Spektori kompetent ka inspektuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka konstatuar se sështë në rregull

në aspektin që prokura e dorëzuar nga personi i autorizuar për të dorëzuar njoftimin nuk ishte origjinal dhe as kopje e noterizuar. Duke marrë parasysh këtë, Agjencia e ka njoftuar përmes telefonit përfaqësuesin e LA KOSTA Vinicë dhe i ka kërkuar që të (redukojë) plotësojë njoftimin. Në datë 19 nëntor në Agjenci ka dorëzuar deklaratë të noterizuar me prokurë dhe kështu dokumentacioni ka qenë i plotë dhe i rregullt, pra i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara me aktet nënligjore përkatëse të Agjencisë. Situat aktuale është se pronar i vetëm i LA KOSTA Vinicë është personi fizik Dafinka Kostadinova, kështu që pas ndryshimit të kërkuar do t'i bashkohet edhe personi fizik Branko Ivanovski i cili do të jetë pronar i vetëm i radios. Si zakonisht, Agjencia ka kryer kontroll dhe ka konstatuar se sipas të dhënave nga Sistemi shpërndarës i internetit të Regjistrimit Qendror të RMV-së, personi Branko Ivanovski figuron si pronar dhe drejtues i Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime INVESTGRUPVIN SHPKNJP Vinicë, veprimtari prioritare e të cilit është tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht me ushqime pra (ushqimore), pije dhe duhan. Ky person juridik nuk figuron si themelues i ndonjë shoqërie tregtare. Po ashtu, Agjencia ka kryer kontroll edhe në Regjistrin e pronarëve të vërtetë, i cili udhëhiqet nga Regjistri Qendror, dhe sigurimin e Situatës aktuale të pronarit të vërtetë për Branko Ivanovski, me të cilën u konfirmuan të dhënat e deklaruara. Meqënëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë nuk krijojnë përqëndrim të paligjshëm mediatik në aspektin e LSHMAAV, sugjerohet që Këshilli të pranojë propozimin dhe të marrë vendim që lejon ndryshimin e strukturës së pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendimin me të cilin lejon ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë, me tekst siç është propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë nuk krijohet përqëndrim i kundërligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga i njëjti Ligj.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pikat 7, 8 dhe 9

Z.Petrushevski e pyeti udhëheqësen Ljubevska nëse raportet e propozuara janë nga e njëjta mbikëqyrje apo nga mbikëqyrje të ndryshme?

Udhëheqësja Ljubevska sugjeroi që Pikat 7, 8 dhe 9 të shqyrtohen (rishihen) dhe të sqarohen me një hyrje dhe një diskutim sepse i referohen të njëjtës shkelje (vepër) të neneve në Ligj dhe pastaj të votohet ndarazi për secilën masë..

Z.Petrushevski e pranoi propozimin.

Udhëheqësja Ljubevska sqaroi se më 6 shtator janë bërë mbikëqyrje të rregullta mbi shërbimin programor të TV Alsat-M, TV Alfa dhe TV Sitel, me ç'rast është konstatuar shkelje e rregullave për të mitur. TV Alsat dhe TV Alfa transmetojnë njoftime promocionale për programet artistike pa shenjën vizuale që sinjalizon kategorinë e programit. Për TV Sitel, njoftimet promocionale për programet e transmetuara janë shënuar me sinjalin paralajmërues vetëm para fillimit, por jo dhe gjatë transmetimit të tyre. Prandaj propozohet që t'i shqiptohet

masë vërejtje publike dhe të udhëzohen transmetuesit e përmendur në afat prej 30 ditësh pas marrjes së vendimit të harmonizojnë veprimtarinë e tyre me Ligjin.

Votimi sipas pikës 7

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e krye të rregullt programore, nr.10-3624/1 datë 30.9.2022 dhe njëzëri konkludoi që t'i shqiptohet masë vërejtje publike Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 6 shtator 2022, janë transmetuar njoftime promovuese për program artistik pa u shënuar me sinjalizim për mbrojtjen e të miturve.

Në pajtueshmëri me pikën 6 të Udhëzuesit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK Shkup obligohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë vendimin për shqiptim të masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike duhet të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas pikës 8

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore me nr.10-3658/1 datë 4.10.2022 dhe njëzëri konstatoi që ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALFA TV SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi (2) të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 6 shtator 2022, janë transmetuar njoftime promovuese për serialin artistik „Asi“, pa u shënuar me shenjën vizuale që sinjalizon kategorinë e programit që do paraqitet.

Në pajtueshmëri me pikën 6 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, ndaj SHTR ALFA TV SHPKNJP Shkup obligohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik duhet të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendimin për vërejtje publike duhet të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i

mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas pikës 9

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore me nr.10-3628/1 datë 30.9.2022 dhe njëzëri konstatoi se Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SITEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 6 shtator 2022, në programet e transmetuara „Çikago PD“, „Semejstvoto na duhovi 2020“ dhe „Lav Lajv! Sonce!“, janë shënuar me sinjalin paralajmërues vetëm para fillimit, por jo dhe gjatë transmetimit të tyre.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SITEL SHPKNJP Shkup obligohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike duhet të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 10

Udhëheqësja Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj TV 21-M për shkelje të nenit 55 paragrafët (6) dhe (7) nga LSHMAAV. Ajo shpjegoi se mbikëqyrja është kryer më 6 tetor në programin e transmetuar më 23 shtator dhe se mbikëqyrja ka qenë e jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare. U konstatua shkelje e rregullave në lidhje me vendosjen e produkteve për faktin e transmetimit të një shtojce në edicion të programit-shou program me funksion mediatk argëtues „Pastel“, ku produkteve të promovuara iu dha një rëndësi e teprua si (theksim ose referencë) të „Zegin“ dhe „JM Organiks“. Prandaj, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike dhe të urdhërohet transmetuesi që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me Ligjin.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes së jashtëzakonshme në rrugë zyrtare, mbikëqyrje programore me nr.10-3763/1 datë 7.10.2022 njëzëri solli përfundimin që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup t'i shqiptoj masë vërejtje publike për shkelje të nenit 55 paragrafët (6) dhe (7) nga LSHMAAV sepse më 23 shtator 2022, në edicionin e programit talk-shou program me funksion

mediatik argëtues „Pastel“, u rekomandua në mënyrë promovuese dhe iu dha një rëndësi e tepruar (theksim ose referim) produkteve të „Zegin“ dhe „JM Organiks“.

Në pajueshmëri me pikën 6 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, ndaj SHTR KOMPANI 21 – M SHPKNJP Shkup obligohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me LSHMAAV.

Spektori për çështje programore dhe furnizim publik duhet të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë vendimin në ueb faqen e Agjencisë.

Pikat 11 dhe 12

Z.Petrushevski propozoi për Pikat 11 dhe 12 të bëhet një hyrje dhe të ketë një diskutim të përbashkët, pasi bëhet fjalë për të njëjtin medium që ka kryer shkelje në dy nene të ndryshme nga LSHMAAV. Më pas votimi duhet të bëhet për secilën pikë në veçanti.

Udhëheqësja Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj TV Alsat-M për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV dhe për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) nga LSHMAAV dhe nenit 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit. Ajo ka shpjeguar se janë kryer mbikëqyrje të rregullta, njëra në përmbajtjen e transmetuar më 7 shtator ndërsa tjetra më 6 shtator. Më 7 shtator u konstatua se transmetuesi nuk i ka respektuar rregullat për transmetimin e programit të krijuar burimor, gjegjësisht nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase dhe as nuk ka transmetuar të paktën gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase në periudhën prej orës 7,00 deri në 19,00. Shkelja e dytë i referohet faktit se në edicionet e serialeve reklamat pop-al u transmetuan në mënyrë të përsëritur në ekran të ndarë që mbulon – pjesë thelbësore të veprimit dramatik dhe nëntitullin e përkthimit si dhe shenjën paralajmëruese për kategorinë e programit dhe logon e Televizionit. Për shkeljen e parë propozohet masë vërejtje publike, për harmonizimin e veprimtarisë me afat respektimi prej 30 ditësh. Për shkeljen e dytë propozohet masë vërejtje publike me afat respektimi prej 15 ditësh.

Z.Ajdini tha se në materialet ka shkresa nga televizioni se ka dhënë deklaratë pas lëshimeve të bëra, pra se pranon gabimet që ka bërë dhe që janë konstatuar nga mbikëqyrjet.

Udhëheqësja Ljubevska sqaroi se përkundër deklaratave të dorëzuara, shkeljet nuk anulohen. Transmetuesi deklaron se ka respektuar menjëherë Ligjin, por kjo do të kontrollohet më tej nga mbikëqyrja e kontrollit.

Votimi sipas pikës 11

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes së rregullt programore me nr.10-3571/1 datë 29.9.2022 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 7 shtator 2022, nuk ka transmetuar të paktën 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase, as nuk ka transmetuar të paktën gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase në periudhën nga ora 7,00 deri në 19,00.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK Shkup detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga neni 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike duhet të përgatisë vendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas mbarimit të afatit të përcaktuar në Vendimin për vërejtje publike kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipër në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi sipas pikës 12

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore me nr.6p.10-3625/1 datë 30.9.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 98 paragrafi (2) nga LSHMAAV dhe neni 14 paragrafi (2) të Rregullores për teknika të reja reklamimi sepse më 6 shtator 2022, në botimet e serive artistike: „Mos më braktis“, „Çakër-familja e madhe“, „Lotët e nënës“ dhe „Më fal“, u transmetuan vazhdimisht pop-al reklama me ekran të ndarë që mbulonin pjesë thelbësore të dramës dhe titrat, si dhe shenjat paralajmëruese për kategorinë e programit dhe logon e Televizionit.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK Shkup, detyrohet që në afat prej 15 ditësh nga dita pranimi të vendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për teknika të reja reklamimi.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë vendimi për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Vendimin për vërejtje publike, duhet të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 13

Z.Petrushevski, në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të caktuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e LFP (ligjit për furnizim publik), tha se në materialet thuhet se Këshilli duhet të japë miratim për shumën që nuk kalon 23.000,00 denarë pa TVSH të llogaritur, por vlera më e ulët është 18.000,00 denarë pa TVSH. Ai shpjegoi se këto mjete (fonde) do të destinohen për transport me autobus të përfaqësuesve të organeve rregullatore nga vendet e ish-Jugosllavisë dhe përfaqësuesve nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Bullgarisë.

Udhëheqësja Ljubevska, në lidhje me vërejtjen e Z.Petrushevski sqaroi se shuma prej 23.000,00 denarë është formuar në bazë të kërkesës që sektori fillimisht e parashtroi sepse në atë kohë ende nuk dihej se sa do të kushtonte ky shërbim. Transporti me autobus nevojitet për konferencën rajonale që ASHMA-ja do të organizojë javën e ardhshme. Pas miratimit të kërkesës, sektori filloi me mbledhjen e ofertave dhe për këtë qëllim arritën tri oferta me shuma të ndryshme, ndërsa oferta më e ulët është 18.000,00 denarë pa TVSH. Rrjedhimisht, i propozohet Këshillit të pranojë propozimin dhe të japë miratimin që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizim të shërbimit-Transport me autobus për konferencë rajonale, me vlerë të caktuar nën kufijtë e vlerës së paraparë për zbatimin e Ligjit për furnizime publike.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizim publik- Transport me autobus për konferencën rajonale, me vlerë të caktuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik e cila nuk do të kalojë shumën prej 23.000,00 denarë pa llogaritur TVSH.

Mjetet për shërbimin e mësipërm sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për 2022.

Z.Petrushevski pas votimit sqaroi se transporti me autobus është për javën e ardhshme të enjten pasdite dhe ftoi të gjithë anëtarët që kanë mundësi të vijnë pas orarit të punës. Autobusi do t'i çojë në linjën e Negotinës dhe më pas do t'i kthejë në Shkup.

Pika 14

Udhëheqësja Ljubevska shpjegoi Propozim-vendimin për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 2 (dy) qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të „Gazetës Zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut“. Ajo që kërkohet është të sigurohen mjete në vlerë prej 22.000,00 denarë me TVSH të llogaritur prej 18%, sepse dy nga qasjet ekzistuese të përdoruesve tashmë kanë skaduar. Ndryshe, Agjencia është shfrytëzues i 6 qasjeve të përdoruesve dhe për atë arsye fitohet zbritje, në vend që të paguhet 15.500,00 denarë me TVSH për një qasje përdoruesi, tani një qasje do të kushtojë 11.000,00 denarë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 22.000,00 denarë me TVSH të llogaritur 18% për rinovimin e 2 (dy) qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve të „Gazetës Zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ për një periudhë 12 (dymbëdhjetë mujore).

Mjetet (fondet) për shërbimin e mësipërm sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele për vitin 2022.

Pika 15

Të ndryshme

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-4013/13

18.11.2022
Shkup

Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v